



KOMUNIKATË

25.02.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur sot, miratoi raportet nga mbledhjet e kaluara 04, 07 dhe 09/ 2010. Pas miratimit të rendit të ditës, kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemaj Peqani, tha se janë bërë specifikat për fletëvotimet dhe listat përfundimtare të votuesëve për zgjedhjet e përsëritura për raundit të dytë për Kryetar të Komunave dhe janë dërguar në Agjensionin e Prokurimit Publik për procedim njëburimor. Është bërë drafti i shpenzimeve për tërë procesin e rivotimit në Gjilan dhe, është duke u punuar drafti operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunën e Istogut.

Kryeshefi Peqani, e ka njoftuar KQZ-së se sot është afati i fundit për t'i propozuar kandidatët për KVV-të për rivotim në Gjilan. Gjithashtu, janë bërë specifikat e materialit zgjedhor: format e paketimit, zarfet, etiketat, formularët e përpilimit të rezultateve (FRP-së), vulat e reja dhe bexhat shtesë për KVV dhe vëzhgues, si dhe për QNR. Gjithashtu, janë duke u bërë pagesat e KVV-e dhe të stafit tjetër teknik të angazhuar në zgjedhjet e përsëritura në Prizren dhe Lipjan, afati i të cilave është deri më 15 prill 2010.

Këshilli për Buxhet dhe Financa, e informoi KQZ-në për shpenzimet e muajit tetor 2009, dhe për buxhetin që duhet të aprovohet për rivotim në komunën e Gjilanit. Blerim Burjani, anëtarë i këtij këshilli, tha se është aprovuar plani i buxhetit për rivotim në komunën e Gjilanit dhe ky buxhet, është më i vogël. Z. Burjani, kërkoi që KQZ ta miratojë këtë buxhet në mënyrë që të shkohet më tutje. KQZ e aprovoi buxhetin për Gjilanin në vlerë prej 218.832 euro. KQZ gjithashtu, miratoi edhe shpenzimet e muajit tetor 2009.

Këshilli për Procedura, e informoi KQZ-në për qëndrimin që ka marrë ndaj ankesës së Partisë së Pensionistëve të Kosovës kundër aplikimit për regjistrim të Partisë së Pensionistëve dhe Invalidëve. Bajram Latifi, kryesues i Këshillit për Procedura, tha se pas shqyrtimit me kujdes të përmbajtjes së ankesës, argumentet e ofruara janë të paqëndrueshme. KQZ me vendim, e ka hedhur poshtë si të pa bazë ankesën e Partisë së Pensionistëve të Kosovës.

Zyra për Regjistrimin e Partive politike, e informoi KQZ-në se më 29 janar iniciativa politike nga komuniteti shqiptar e quajtur Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve (PPI), udhëheqës i të cilës është z. Lush Isufaj, ka dorëzuar aplikacionin e kërkesës për regjistrim si parti politike. Zyra pas pranimit të aplikacionit, e ka kontrolluar dhe verifikuar tërë dokumentacionin dhe sipas ligjit, ky subjekt i plotëson kushtet e parapara për regjistrim. Zyra garanton se i gjithë dokumentacioni i paraqitur, është i kompletuar konformë Rregullës së KQZ-së nr. 01/2008, andaj duke u thirrur në nenin 4.6

rekomandon të nderuar anëtarë të KQZ-së që ta regjistroni këtë iniciativë politike me emrin “Partia e Pensionistëve dhe Invalidëve” (PPI), e cila do të hyjë në regjistër si partia politike e 48-të me radhë, e regjistruar në Kosovë. KQZ ka marrë vendim për regjistrimin e këtij subjekti politik.